



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë:	11.09.2025
Referencë:	
Për:	z.Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje:	z.Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës
Nga:	Anila Reçica Llugiqi - Drejtoreshë e Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport
Lënda:	RAPORT Mujor - GUSHT - 2025

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë muajit gusht, në drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale.

Në raportimet javore e kemi paraqitur përafersisht punën e drejtoratit.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

- Kemi bërë raportin për muajin korrik,
- Kemi shënuar ditën e rinisë me shumë aktivitete:
 1. U organizua Panairi Rinor, ku gjithsej ishin këto aktivitete:
 - Punëtorja e argjilës,
 - Quiz Time,
 - Dhurata për fituesit e garave,
 - Këndi karaoke,
 - Foto me aparat polaroid,
 - Gara me vezë,
 - Këndi i dijes,
 - Këndi i artit,
 - Këndi i lojërave,
 - Këndi i sportit.
 2. Rinia Fest - Lipjan, festivali për Ditën Ndërkombëtare të të Rinjëve, 12 Gushti,
- Në kuadër të aktivitetit **“Rinia Fest”** kemi organizuar edhe pritjen e mysafirëve nga Austria, të cilët si organizatë ndërkombëtare kulturore u prezantuan me një defilim në Sheshin “Adem Jashari”, duke shfaqur kostume tradicionale me qëllim promovimin e kulturës tradicionale austriake
- Si Komunë, përmes DKRS-së, kemi organizuar gjithashtu një vizitë në Shpellën e Gadimes, për mysafirët, me synim promovimin e pasurisë natyrore që posedon Komuna e Lipjanit,
- Mysafirët u pritën edhe nga Kryetari i Komunës, z. Imri Ahmeti, i cili si shenjë falënderimi ndau mirënjohje për mysafirët
- Jemi angazhuar dhe kemi përcjelle informatat te OJQ-të Sportive, Rinore e Kulturore, për oraret e dëgjimeve buxhetore,
- Kemi marr përgjegjësinë e hartimit të orareve të stervitjeve të klubeve lokale të futbollit në Stadionin “Sami Kelmendi”.

STATISTIKAT

Në vazhdim paraqesim raportin në formën tabelare:

1. ZGJIDHJA E LËNDËVE NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE TË PRANUARA NGA PALËT

Tabela-1, -- Pasqyra totale e lëndëve të pranuar nga palët

Gjithsejt	Të Aprovuara	Të Refuzuara	Në Proces	Të Pazgjidhura
42	10	7	25	-

Tabela- 2, -- Kërkesa të parashtruara për Arkivin Komunal – Lipjan

Kërkesat e parashtruara	Të realizuara	Numri i dokumenteve të lëshuara(kopje nga Arkivi)	Në proces	Vërejtje : Te hyrat:
12	7	52	-	26.00€

Tabela- 3, -- Raport për Biblotekën e Qytetit në Lipjan

Vendi	Libra në huazim	Libra të kthyer	Lexues te rinj	Përpunim i librit	Lexues në sallën e leximit	Libra të dhuruara
Spektori për fëmijë	148	150	42	155	11	910
Spektori për të rritur	100	80	10	-	90	--

Tabela- 4, -- Raport për Biblotekën në Gadime

Libra në huazim	Libra të kthyer	Lexues te rinj	Përpunim i librit	Lexues në sallën e leximit
34	27	7	18	-

Tabela- 5, -- Raport për Biblotekën në Shalë

Libra në huazim	Libra të kthyera	Lexues te rinj	Përpunim i librit	Lexus në sallën e leximit
39	35	3	-	-

DISKUTIME PUBLIKE

Kemi pasur një diskutim publik me të rinjët e komunës së Lipjanit si dhe kemi qenë pjesmarrës bashkë me grupet e OJQ-ve në konsultimet publike për Hartimin e Buxhetit për vitin 2026 – 2028.

TAKIME TJERA

Gjatë muajit gusht janë realizuar takime fizike me pale duke trajtuar me kujdesë të veçantë kërkesat e tyre dhe mundësitë e bashkëpunimit.